



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 2 SHTATOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 18:00)

Rendi i ditës:

1. Hapja e Sesionit V të Legjislaturës IX të Kuvendit të Shqipërisë.
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 18.07.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*
3. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*
4. Njoftimi/miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 2 shtator-18 tetor 2019 *(neni 26, pikat 5 dhe 6 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*
5. Njoftimi/miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 2 - 20 shtator 2019 *(neni 27, pikat 3 dhe 4 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Gramoz Ruçi – Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

Në mbështetje të neneve 74, pika 1, të Kushtetutës dhe 42, pika 1, të Rregullores, sot hapim Sesionin V parlamentar të Legjislaturës IX.

Më lejoni, meqë është dita e hapjes së sesionit, të marr fjalën për të shprehur mendimet e mia lidhur me sesionin e kaluar dhe objektivat e këtij sesioni. Më pas, sipas dëshirës, mund ta marrin fjalën përfaqësuesit e grupeve parlamentare për të shprehur mendimet e tyre për sesionin që lamë pas apo edhe për sesionin që po nisim sot.

Të nderuara qytetare dhe qytetarë të Shqipërisë,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Në nisje të sesionit të ri, po paraqes disa arritje e probleme të sesionit të kaluar dhe prioritetet e sesionit të ri parlamentar.

Sesioni që mbyllëm ishte një sesion jo i lehtë. Megjithatë, vështirësitë që u shkaktuan nga dëgjia e mandateve të deputetëve të opozitës nuk e penguan funksionimin e sistemit politik, produktivitetin dhe rezultatet e Kuvendit. Rreth 70% e mandateve, 40 nga 58, u zëvendësuan shumë shpejt nga deputetët e rinj të opozitës dhe kjo ndihmoi në rikthimin në normalitet e legjitimitet të Kuvendit.

Kuvendi e ushtroi me intensitet dhe sukses funksionin e tij kryesor, atë legjislativ. Gjatë sesionit që lamë pas u depozituan 64 projektligje, nga të cilat u miratuan gjithsej 57 ose 2 më shumë sesa i njëjti sesion i vitit të kaluar, si dhe u miratuan 86 vendime. U miratuan 5 ligje me 3/5-at, ndërkohë që gjatë sesionit të vitit 2018 me 3/5-at nuk u miratua asnjë ligj. U miratuan 28 ligje me konsensusin e opozitës ose 21 ligje më shumë sesa periudha janar-korrik e vitit të kaluar. Deputetët morën 19 nisma ligjore ose 8 më shumë sesa periudha janar-korrik 2018, njëra prej të cilave për ndryshimin e Kodit Penal.

Deputetët e opozitës kanë kërkuar 6 interpelanca ose 2 më shumë sesa i njëjti sesion i vitit të kaluar, prej të cilave u zhvilluan 5. Është zhvilluar një mocion me debat dhe në Kuvend kanë raportuar 21 institucione ose 2 më shumë se në sesionin e njëjtë të vitit të kaluar. Për 16 raportime u paraqitën kërkesa për debat në seancë plenare, si dhe janë miratuar 25 rezoluta ose 3 më shumë sesa sesioni i kaluar, nga të cilat 21 për veprimtarinë vjetore të këtyre institucioneve.

Kuvendi mbylli sesionin e kaluar dhe fillon këtë sesion parlamentar si një institucion funksional me një kuorum kushtetues e shumicë të kualifikuar për të miratuar çdo akt ligjor dhe kjo shpreh edhe një përgjegjësi të lartë të grupit opozitar si një përgjegjësi kombëtare, kushtetuese e politike, për të cilën meritojnë mirënjohjen e të gjithë shoqërisë shqiptare.

Kuvendi përballoi me dinjitet sfida të jashtëzakonshme dhe unike. Demokracia liberale si asnjëherë gjatë tri dekadave u provua si demokraci kushtetuese dhe vetë konstitucionalizmi si themeli solid i saj. Si asnjëherë në historinë e pluralizmit Kushtetuta u rezistoi aventurave dhe parimi i *Magna Cartës*

“Liri nën ligj” shpëtoi sistemin demokratik të Shqipërinë nga anarkia dhe kaosi.

Reforma në drejtësi ishte argumenti më bindës për rekomandimin pozitiv të Komisionit European për hapjen pa kushte të negociatave me Shqipërinë.

Gjatë sesionit të kaluar përmbyllëm detyrimet për miratimin e 30 akteve të reformës në drejtësi, me miratimin e 2 ligjeve dhe të 1 vendimi, në zbatim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për funksionimin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Reforma në drejtësi, siç e kemi thënë edhe herë të tjera, është meritë ekskluzive e Kuvendit të Shqipërisë dhe shërbimi më i mirë për qytetarët, për shtetbërjen dhe të ardhmen e vendit.

Vijum me ngritjen dhe plotësimin e institucioneve të reja.

Në Kuvend, siç dihet, do të dorëzohen shumë shpejt kandidaturat për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë.

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” ka monitoruar ngritjen e institucioneve të reja të sistemit, ka bërë analiza e vlerësime, si dhe ka dhënë rekomandime, të cilat u janë përcjellë në mënyrë periodike Komisionit të Ligjeve dhe institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë.

Roli thelbësor i Kuvendit për integrimin european u konkretizua në tri aspekte: në garantimin e legjitimitetit demokratik, sigurimin e kontrollit ligjor e politik dhe intensifikimin e diplomacisë parlamentare.

Miratuam ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, duke e përshtatur atë me dispozitat e ligjit nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritet të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, si dhe duke zbatuar rekomandimin e përsëritur edhe në raportin e Këshillit European për vitin 2019.

Fuqizua veprimtarinë e organeve të Kuvendit, përgjegjëse për integrimin, si Komisioni i Integritet European dhe Këshilli Kombëtar i Integritet European.

Përmirësuam cilësisht përputhshmërinë e ligjeve me standardet e Bashkimit European.

Komisioni për Integrimin Europian miratoi 9 projektligje me përafrim ose 1 më shumë, si dhe propozoi 34 amendamente ose 7 me shumë krahasuar me periudhën janar- korrik 2018.

Risi ishte zbatimi për herë të parë i nenit 18, pika 1, e ligjit për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit.

Në seancën plenare të 11 prillit, Kuvendi miratoi rezolutën “Mbi progresin e Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Europian përgjatë vitit 2018”, e cila i kërkoi qeverisë të thellojë reformat në prioritetet kyçe për hapjen e negociatave.

9 nga 46 masat e planit të veprimit të Kuvendit për integrimin, që janë realizuar pjesërisht, do të barten në planin e vitit 2019.

Në sesionin e kaluar intensifikuam diplomacinë parlamentare. Zhvilluam vizita e takime të rëndësishme me kryeparlamentarë të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, si me presidentin e Bundestagut gjerman, kryetarët e parlamenteve e senateve të Austrisë, Italisë, Holandës, Republikës Çeke, kryetarët e parlamenteve të Sllovenisë, Kroacisë, Greqisë, Maltës, Suedisë, Hungarisë, Polonisë, me zëvendëskryetaren e Asamblesë Kombëtare të Francës e të tjerë.

Në takime shumëpalëshe u takuam me pothuajse të gjithë kryeparlamentarët e vendeve të Bashkimit Europian. Gjatë këtyre vizitave apo takimeve të mësipërme zhvilluam seanca dëgjimore me komisionet e jashtme ose të çështjeve europiane, ku shpjeguam me prova e detaje arritjet e Shqipërisë në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit Europian.

Vlera e shtuar e diplomacisë parlamentare ishte prezantimi bindës i realizimit të plotë të rekomandimeve të Këshillit Europian. Rekomandimi i Komisionit për çeljen pa kushte të negociatave është një produkt i arritjeve, por edhe i prezantimit të tyre. Në mbledhjen e Këshillit Europian do të shkojmë me sigurinë e plotësimin të rekomandimeve.

Kontrolli parlamentar ishte një prioritet i Kuvendit gjatë sesionit që lamë pas. Në zbatim të nenit 103 të Rregullores, 23 institucione të pavarura depozituan raportet vjetore dhe 21 titullarë të tyre raportuan në seancat plenare.

Kuvendi shqyrtoi raportet dhe analizat e Shërbimit të Monitorimit, miratoi 21 rezoluta për

veprimtarinë e institucioneve, si dhe rekomandimet për vitin 2019.

Komisionet organizuan 53 seanca dëgjimore, nga të cilat 23 për shqyrtimin e raporteve të institucioneve, drejtuan 630 pyetje dhe paraqitën në seancat plenare 19 rezoluta.

Gjithashtu, komisionet zhvilluan 11 vizita pranë këtyre institucioneve, duke lënë edhe detyra konkrete.

Platforma ndërinstitucionale *online* u ndërtua dhe do të fillojë të funksionojë brenda shtatorit, duke rritur rolin mbikëqyrës e monitorues të Kuvendit ndaj këtyre institucioneve.

Për herë të parë vlerësimet dhe rekomandimet e Kuvendit për institucionet u publikuan në përmbledhjen “Institucionet e pavarura në Kuvend, 2018”.

Platforma *online* dhe botimi po krijojnë një komunikim e bashkëpunim të ri me institucionet e pavarura. Ato fuqizojnë kontrollin parlamentar dhe rrisin autoritetin e tyre në funksion të interesit publik dhe atij qytetar.

Krahas arritjeve e problemeve të mësipërme, më lejoni të paraqes edhe disa prioritetet të sesionit të ri parlamentar.

Siç e përmenda, dëshira e të gjithëve ne, por ç’është më e rëndësishmja, dëshira e të gjithë shqiptarëve, është çelja e negociatave. Qytetarët shqiptarë presin me mendje e me zemër datat 17-18 tetor të këtij viti dhe ne duhet ta përdorim këtë fillim sesioni për të kompensuar ato çka nuk mundëm t’i bënim mirë gjatë sesionit të kaluar.

Prandaj, prioriteti i parë do të jetë përmbyllja e reformës zgjedhore dhe përfshirja e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, përfshirë këtu edhe rekomandimet e zgjedhjeve të 30 qershorit.

Reforma zgjedhore do të jetë një produkt konsensual i Kuvendit, duke përfshirë këtu jo vetëm opozitën parlamentare, por edhe atë jashtëparlamentare.

Dora e shtrirë e Kuvendit për opozitën jashtë tij nuk është mëshirë për “djalin plangprishës”, por harmonizim i konstitucionalizmit, si elementi thelbësor i përhershëm i demokracisë, me kompromisin politik, si gjendje e përkohshme e saj. Mbrojtja e Kushtetutës sot është garancia e Shqipërisë nesër.

Planin e veprimit të Kuvendit për integrimin, për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në raportin e vitit 2019 të Këshillit Europian, do ta miratojmë brenda këtij muaji.

Reforma në drejtësi do të vazhdojë, duke synuar përfundimin e ngritjes, plotësimit dhe bërjes funksionale të institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit, raportimin e tyre në Kuvend dhe mbështetjen me burime njerëzore, financiare e materiale, sipas nevojave.

Gjykata Kushtetuese dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të zgjidhen dhe do të bëhen funksionalë shumë shpejt. Do të rishikojmë ligjin për rolin e Kuvendit për integrimin, për të krijuar një mekanizëm të ri për mbikëqyrjen e punës së qeverisë gjatë negociatave.

Fuqizimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit do të vazhdojë, duke e orientuar qeverinë drejt përgatitjes me përparësi të ligjeve që mbështesin zhvillimin, mirëqenien dhe mbrojtjen shoqërore për qytetarët.

Kontrolli parlamentar do të intensifikohet dhe do të fuqizohet nëpërmjet seancave dëgjimore me institucionet e pavarura dhe nëpërmjet formave të tjera, si: organizimi i aktiviteteve kontrolluese në institucione dhe territore, si dhe përfshirjen e kësaj praktike në Rregulloren e Kuvendit; kontrolli i deputetëve nëpërmjet pyetje-përgjigjeve dhe publikimit të tyre në faqen e Kuvendit; kërkesave të shumta për informacione të ndryshme; zbatimi i platformës elektronike për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve; botimi periodik i raporteve të institucioneve dhe i rezolutave parlamentare për to, si dhe përdorimi i instrumenteve të ndryshme parlamentare, siç janë: seancat e pyetjeve, të interpelancave dhe të mocioneve me debat me qeverinë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sesioni që po nisim sot, përkon me kremtimin e 75-vjetorit të çlirimit të atdheut, një ngjarje monumentale e historisë sonë kombëtare.

Çlirimi i Shqipërisë është meritë e ushtrisë dhe e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pa këtë luftë ndjenjat dhe rezistenca antifashiste shqiptare do të ishin asgjësuar nga bisha nazifashiste.

Lufta jonë Nacionalçlirimtare, ashtu si Lufta e Dytë Botërore, nuk u fitua si përplasje idesh, por në betejë të përgjakshme në male, në

detë, në qiell dhe në qytetet e globit, ku ranë me dhjetëra milionë ushtarë luftëtarë.

Ushtria Nacionalçlirimtare luftoi denjësisht në krah të Ushtrisë së Kuqe, marinës dhe flotës amerikane, ushtrisë dhe flotës britanike, si dhe e flotës franceze. Ishte pikërisht kjo luftë që e vendosi Shqipërinë në anën e duhur të historisë.

Me këtë rast ju bëj thirrje të gjithëve ju, kolegë deputetë, që të merrni pjesë aktivisht në përkujtimin e ngjarjeve të luftës dhe të çlirimit në të gjithë territorin e vendit.

Qeveria dhe komisioni i ngritur për këtë qëllim duhet të shpejtojnë ritmet për realizimin e veprimtarive të programuara në këtë përvjetor të rëndësishëm.

Institucionet shtetërore e akademike duhet të rrisin frymën e bashkëpunimit me organizatat e veteranëve, në mënyrë që kremtimi i 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë të realizohet me madhështinë që meriton Lufta Nacionalçlirimtare, që sakrificat dhe vetëmohimi të vlerësohen me shkëlqimin që meritojnë.

Të nderuar kolegë,

Përpara kemi edhe një jubile tjetër të rëndësishëm. Në janar të vitit 2020 do të kremtojmë 100-vjetorin e parlamentarizmit shqiptar. Ju informoj se Byroja e Kuvendit ka miratuar vendimin përkatës në muajin maj me një program të gjerë aktiviteteve. Për realizimin e këtyre veprimtarive, Shërbimet e Kuvendit po bashkëpunojnë me institucionet shtetërore dhe shkencore të vendit, si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Albanologjisë, Drejtorinë e Arkivave, Radio-Televizionin Shqiptar, Muzeun Kombëtar, Postën Shqiptare, Arkivin e Filmit, Agjencinë Telegrafike Shqiptare, shkollat e mesme të Tiranës, të Lushnjës e të tjerë.

Vendimi dhe programi janë në faqen e Kuvendit dhe u janë nisur të gjithë deputetëve. Prandaj, ftoj të gjithë deputetët që, për realizimin e këtyre aktiviteteve, të japin kontributin dhe të bëjnë vlerësimet e tyre sipas mundësive që kanë.

Shtatori, si muaji kushtuar reformës në drejtësi, tetori, si muaji vendimtar për negociatat, nëntori, si muaji i 75-vjetorit të çlirimit dhe dhjetori, si muaji i kurorëzimit të aktiviteteve të 100-vjetorit të parlamentarizmit, do të jenë kronologjikisht katër kantieret kryesore të këtij sesioni.

Duke përfunduar, jam i bindur se të gjithë bashkë do të realizojmë një sesion të mbarë e produktiv.

Punë të mbarë të gjithëve!

Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me seancën.

Nga Grupi Parlamentar i Partive të Djathta, kush e do fjalën?

Zoti Alimadhi, dëshironi ta merrni fjalën?

Fjala për ju.

Adriatik Alimadhi - Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryetar,

Më lejon t'i uroj suksese gjithsecilit në sesionin e pestë të legjislaturës së nëntë të këtij Kuvendi dhe mbarësi në vazhdimësi!

Sot, për herë të parë, isha në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe pashë projektprogramin. Të them të drejtën, më la hapësira për të theksuar disa problematika, që shoqëria shqiptare i ka hasur për gati 30 vjet.

Në fakt, zakonisht këtë parlament e kam ndjekur nga jashtë, por sot që jam brenda tij kam parë se aty nuk bëhen ligje, por gracka.

Unë mendoj se sot shoqëria shqiptare ka shumë problematika, sepse të gjithë po shikojmë se si shumë shqiptarë po vriten për prona. Pra, ju e shikoni se ky vend dhe kjo shoqëri kanë nevojë për një ligj të mirë për pronat. Ju e shikoni se çdo shqiptar sot ka lënë pronën peng në bankë. Mendoj se ky Kuvend duhet të ndërmarrë nisma ligjore për të bërë një ligj të mirë për bankat. Kur ju qëndroni në çdo karburant, e keni parë se një litër karburant ka shkuar 2000 lekë të vjetër, ndaj duhet një ligj i mirë për hidrokarburet. Ju e shikoni se gjithçka në këtë vend është bërë gangrenë për shkak të kësaj politike 30-vjeçare. Ja ku i keni shqiptarët, të cilët presin që të takohen dy liderët e famshëm që të zgjidhin problemet e tyre!

Diçka tjetër që vura re është se Kryetari i Kuvendit, me të drejtë, përmendi 75- vjetorin. Shikoni çfarë bie tjetër në sy. Kryetari i Kuvendit përmendi 75- vjetorin e çlirimit. Ku shikojmë ne shqiptarët? Sa e çuditshme është! A e kuptoni që kjo Shqipëri kullon gjak shqiptarësh? A e kuptoni që janë vrarë 5-6 mijë shqiptarë? Si mund të quhet "e lavdishme"? Çfarë bëhet kështu? Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë na fton të shikojmë te baballarët e atyre që kanë vrarë njerëzit tanë. Çfarë duhet të bëjmë ne? Është turp! E dini çfarë më thanë?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, të mbaroj unë dhe më pas flisni ju, kur të keni radhën.

Një anëtar i të Partisë Demokratike, i ra telefoni dhe i thanë: "Më tha Kryetari se duhet të vish nesër për 5 Maj". "Çfarë është 5 Maji?" "5 Maji është Dita e Dëshmorëve". Ai u përgjigj: "Si mund të vij unë për 5 Maj, kur ai më ka vrarë gjyshin?"

Ju, të dy krahët politikë, ju ka bashkuar 5 Maji, zotërinj, dhe unë kam diçka shumë të rëndësishme për t'ju thënë: largohuni, sepse po e mbani të përçarë këtë vend!

Unë jam kryetar i Ballit Kombëtar dhe kur shkoj në kafene, pyesin: "Cili kryetar është ky? Kryetari i pulave? Kryetar i bashkëpunëtorëve?" Kështu do ta orientojmë ne këtë shoqëri? A e kuptoni çfarë po bëni? Ku po e çoni këtë shoqëri? Unë sinjerisht mendoj...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem!

E di që është temë e nxehtë, që prek secilin prej jush, por, në fund të fundit, ne jemi vrarë, ne jemi pushkatuar, ne jemi burgosur, ne jemi internuar e jemi përbuzur padrejtësisht.

Po ju kërkoj një nder, meqenëse keni besë shqiptari, megjithëse edhe besën ju nuk e mbani: a ka mundësi të ndërmarrim një nismë për historinë? Ku do të shikojmë ne, shqiptarët? A do t'i japim dorën njëri-tjetrit ne, shqiptarët? E keni parë Kryeministrin e vendit kur shkon në trevat shqiptare? Ia merr dorën Kryeministrit të Kosovës dhe i thotë: "Të kemi patriotizëm, sepse do të bëjmë bashkimin".

Kush u vra për këtë bashkim? Kush u vra për Kosovën? Kush u vra për trevat shqiptare? "Pa Kosovë dhe Çamëri nuk ka Shqipëri", ka thënë Balli Kombëtar.

Zotëri, ju do t'i fitoni të gjitha të drejtat me padrejtësitë tuaja? Çfarë është kjo?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, do ta hamë edhe një pulë dhe ty do të të japim një kockë.

Ju nuk na lini të flasim seriozisht, sepse talleni.

Para disa ditësh i kam kthyer përgjigje një kolegut tonë deputet, zotit Braho. Në statusin e *whats up*-it të Komisionit të Ligjeve, një deputet i drejtohet një zyrtari të lartë të Autoritetit të Informimit të Dosjeve, duke thënë: "Kjo është plehrë". A e kuptoni me çfarë parlamenti dhe me

çfarë mendësie kemi të bëjmë ne? Ju lutem, largohuni, zhvishuni pak! Bëhuni njerëz normalë. Ç'është kjo? Ende do të ngelemi armiq ne? Ende do të ngelemi bashkëpunëtorë? Ende do të ngelemi tradhtarë? Ç'është kjo mendësi?

Po shfrytëzoj rastin, meqenëse Kryeministri ndodhet për herë të parë këtu: ju lutem, me dorë në zemër, të nisim punën për projektligje, të cilat janë në dobi të shoqërisë shqiptare.

Ju po thoni: “Do të bëjmë këtë, do të bëjmë atë”. A e kuptoni? Kush i ka vjedhur votat në 30 vjet? PS-ja dhe PD-ja. Ju keni vjedhur votat e Ballit Kombëtar, Partisë Republikane, atyre që janë atje. Na keni vjedhur votat. Kush e futi mënyrën e vjedhjes së votave? Ju. Ju keni kapur të gjithë sistemin. A e dini se çdo të thotë “i gjithë sistemi”? Për ju votojnë vetëm interesaxhinjtë. Pra, ju keni pas vetes Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet të cilit merrni vendime. Ju keni pas vetes të gjithë administratën. Ju i keni kapur të gjithë pas vetes me lekë.

Po ju bëj një propozim: ndryshoni sistemin! Asnjë forcë politike të mos marrë qoftë edhe një qindarkë nga buxheti i shtetit. Me lekët e kontribuesve tuaj bëni fushatë, zotërinj, dhe hajdeni, bujrum, të përplasemi në zgjedhje, kush fiton dhe kush merr votat. Por ju e keni kapur të gjithë sistemin, keni kapur të gjithë votuesit. Ku do të shkojnë të tjerët? Unë uroj që për këto ligje apo mendime që dhashë sot, të na dëgjojë dikush dhe t'i marrim për nisma ligjore. Personalisht, me grupin parlamentar të partive të djathta, jemi të gatshëm.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Fjalën e ka zoti Nimet Musaj nga Grupi Parlamentar i Pavarur.

Nimet Musaj – I nderuar Kryetar, faleminderit!

Të nderuar kolegë, qytetarë të Shqipërisë,

Sot për ne nis një sesion i ri parlamentar, i pesti i legjislaturës së 9-të, që përkon, gjithashtu, me afatet kohore të reformës më të rëndësishme, asaj për të cilën ne të gjithë bashkë këtu flasim përditë, reformës zgjedhore, ndryshimi i sistemit zgjedhor.

Në emër të Grupit Parlamentar të Pavarur, si personalisht, apo edhe përmes deputetëve të spikatur të këtij grupi, në mënyrë të

vazhdueshme i kemi dhënë mbështetje të plotë dhe të pakushtëzuar politike ecurisë së kësaj reforme. Kjo reformë nuk ka ecur me ritmet e duhura për diçka dhe ne e dimë. Arsyeja për këtë vonesë nuk qëndron tek asnjë nga deputetët e opozitës. Që në krye të herës jemi shprehur se në koordinim me atë çfarë OSBE-ODIHR-i këshilloi për sugjerimet e partnerëve ndërkombëtarë, që do të shprehin interes për përfshirjen në këtë proces, loja e afateve dhe e shtyrjeve të pakuptimta duhet të përfundojë një herë e mirë.

Ne, deputetët e opozitës, mbetemi të vendosur që t'u japim shqiptarëve një garë të standardeve me rregullat më të mira dhe më të drejta të reformës zgjedhore: zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Afati i fundit i përcaktuar, që pa asnjë diskutim duhet të jetë një objektiv i përmbushur, përkon me festat kombëtare, me festën e Çlirimit dhe me festën e Pavarësisë së vendit tonë.

Edhe simbolikisht, përmes punës së këtushme dhe vullnetit politik, duhet t'i pavarësojmë shqiptarët nga praktikatat e mbrapshta të së shkuarës dhe t'i çlirojmë nga pamundësia e pajisjes së një përfaqësimi edhe më dinjitoz në të gjitha nivelet e pushtetit, ku përfaqësuesit të zgjidhen nga qytetarët dhe nga vota e lirë. Kjo është reforma e madhe për konkretizimin e së cilës shumë prej nesh morën mandatin e deputetit dhe duruan shumë sulme denigruese, që buronin nga penguesit e vërtetë të reformave. Ky ishte çmimi që deputetët opozitarë paguan. Por nuk ka përse për frikë të antireformistëve ngecja e reformës zgjedhore të shërbejë si çmim. Kurrsesi jo.

Të nderuar zotërinj deputetë, në mënyrë të veçantë kolegë me më shumë përvojë në sesionin e shkuar dhe më parë, deputetët e rinj sollën një qasje të re në mbarëvajtjen e punëve në këtë sallë.

1) Ne deputetët e rinj instaluam një komunikim politik në nivele të kënaqshme.

2) E kthyem parlamentin drejt ligjeve dhe jetës parlamentare, duke e ndarë njëherë e përgjithmonë nga shfaqjet teatrale me tekste sa bajate, aq edhe banale.

3) Ne bashkërisht, këtë më vjen keq që e listoj si arritjen tonë, sepse në rrethana normale do të ishte detyrimi ynë etik dhe i padiskutueshëm në këtë parlament, bëmë që

seanca plenare të ndiqet nga të gjitha moshat, për shkak se fjalori banal i përdorur u pastrua dhe niveli i diskutimeve u rrit nga ne, deputetët e rinj.

4) Në këtë sallë ne te njëri-tjetri nuk pamë armikun, por bashkëpunëtorin e palës politike përballë, me të cilin duhet të ndahen pikëpamje të ndryshme për të njëjtat nisma ligjore.

5) Ne ecëm përpara. Në leximin tim, kjo rritje e “stekës parlamentare” ishte objektivi i përmbushur nga ne, ndër më kryesorët e sesionit që sapo lamë pas.

Në të njëjtën frymë dhe në emër të Grupit të Pavarur, dua të shpreh zotimin se ky është dhe do të mbetet drejtimi ynë në këtë legjislacion të ri.

Si deputet i Kuvendit të Shqipërisë i qarkut Fier, dua të bëj një bilanc edhe për sezonin turistik, i cili është shumë i rëndësishëm ekonomisht për këtë qark.

Në qytetin e Fierit sezoni turistik është drejt kurorëzimit me shumë sukses, ku në mënyrë të veçantë rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur Policia e Shtetit për mbarrëvajtjen e qarkullimit, rendit dhe sigurisë, si dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal, e cila ka qenë e gatshme për çdo emergjencë.

Së fundi, njerëz me prirje të pashërueshme për të nxirë përmes shpifjes gjithçka, shprehin të gjithë talentin e tyre të mbrapshtë në shtrembërimin e një ngjarjeje që nuk i bën mirë qytetit të Fierit. Askush nga këta nuk komenton momentin dhe rëndësinë e ndihmës së parë të dhënë nga punonjësit e spitalit të Fierit në përmbushje të detyrës së tyre; askush nga këta nuk komenton gatishmërinë dhe përkushtimin, pavarësisht momentit delikat pas incidentit të rëndë në ambientet spitalore, e atij stafi model drejtuesish, mjekësh dhe infermierësh; askush nuk ndalet për të vlerësuar punën e Drejtorisë së Policisë së qarkut Fier, e cila bën një performancë të shkëlqyer në luftën e përditshme kundër kriminalitetit, edhe pse qarku i Fierit nuk është një terren i qetë, por këta e nxijnë punën e atyre burrave dhe grave në këtë qark.

Në vorbullën e atyre thashethemeve, u përfshinë edhe kolegët tanë. Pra, kultura e shpifjes, që nuk kursen asgjë, padrejtësisht dhe pandershmërisht ka shtënë mbi vetë Kryetarin e Kuvendit, por edhe mbi vetë Kuvendin.

Këtu nuk flas vetëm si deputet, por edhe si qytetar i Fierit që e di se kush është kush. Unë hedh pas krahëve shpifjet dhe lidhjet e trilluara të kolegëve të nderuar të kësaj salle me autorët e kësaj ngjarjeje të rëndë, për të cilën jam i sigurt që pas punës së mirë të policisë, drejtësia do të veprojë.

Ky parlament, fatmirësisht, u nda njëherë e mirë nga kultura e shpifjes dhe e imagjinatës pa fre, e cila nuk merrte përsipër përgjegjësi për nxirjen pa baza të çdo arritjeje dhe sulmit ndaj çdo institucioni, që vërtet bën punë të mirë.

Nga kjo foltore unë dua të përgëzoj punën e shkëlqyer të stafit të Spitalit Rajonal të Fierit gjatë këtij tremujori shumë të ngarkuar veror.

Në mënyrë të veçantë përgëzoj Policinë e Shtetit, e cila zbardhi të plotë ngjarjen e rëndë e të paprecedentë dhe në kohë rekord vuri përpara përgjegjësisë autorët e ngjarjes, të cilët e shqetësuan jo pak opinionin publik të këtij qyteti.

Pra, duke kuptuar se kemi ardhur në një fazë të re, duke e ditur se e ardhmja xhiron më shpejt se nga ç’mendohet, reforma zgjedhore dhe reformat e tjera të mëdha ky parlament duhet t’i mbyllë këtë sesion parlamentar.

Një kulturë e re parlamentare dhe politike është edhe një qasje e re me afate kohore për këta objektiva madhorë të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjalën e ka kryetarja e Grupit Demokrat, zonja Rudina Hajdari.

Rudina Hajdari – Përsëndetje të dashur deputetë!

I nderuar drejtues i seancës,

Dua ta filloj diskutimin tim duke përgëzuar deputetët Alimadhi dhe Musaj për fjalimet e tyre, të cilët parashtruan prioritetet që do të ketë opozita në parlament, prandaj edhe unë dua të ndaj me ju fjalën time në emër të Grupit Parlamentar Demokrat.

Më lejoni të filloj duke thënë se nuk ka asnjë dyshim që kjo qeveri është një nga qeveritë më skandaloze që ka parë ndonjëherë vendi. Këtë nuk e them vetëm unë, por dëshmohet qartë nga të gjitha raportet ndërkombëtare, si në raportet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, FMN-së e të tjerë.

Më lejoni t’ju them se nuk ka asnjë dyshim që ne kemi korrupsion të lartë në vend dhe, pa

dyshim, kemi një Kryeministër, i cili ka sjellë regresin e Shqipërisë.

Këtu kemi një qeveri, e cila në 6 vjetët e fundit nuk ka ditur të menaxhojë ekonominë e vendit.

Nuk ka asnjë dyshim që kjo qeveri nuk ka vullnetin dhe dëshirën për të nxjerrë përpara përgjegjësisë zyrtarë të lartë, që akuzohen për korrupsion.

Nuk ka asnjë vullnet politik për të hapur dosjet nr.339 dhe nr. 84, të cilat shumë shpejt do të mbyllën dhe zyrtarët e lartë nuk kanë për t'u ndëshkuar, kjo e dëshiruar si nga shqiptarët, por edhe nga ndërkombëtarët.

Nuk ka asnjë dyshim që skema e fundit e partneritetit publik privat mund të konsiderohet si një nga skemat më korruptive dhe keqbërëse në ekonominë e tregut. Nuk ka asnjë dyshim që kjo skemë ka fundosur buxhetin e shtetit dhe është e rrezikshme për ekonominë e vendit.

Nuk ka asnjë dyshim se në 6 vjetët e fundit Shqipëria nuk ka pasur asnjë investim të huaj. Këtë e tregojnë qartë të gjitha raportet e fundit.

Nuk ka asnjë dyshim që shqiptarët po largohen çdo ditë e më shumë dhe të rinjtë nuk duan ta ndërtojnë të ardhmen në Shqipëri.

Nuk ka asnjë dyshim që bandat kanë zaptuar vendin dhe kanë pushtet mbi pushtetin.

Kush është fajtor për këtë situatë? Kush është fajtor për situatën e këtyre vjetëve të fundit, e cila erdhi si pasojë e 25 qershorit? Përpara 25 qershorit ne kishim një qeveri tranzitore nga marrëveshja mes Ramës dhe Bashës. Nëse ne biem dakord se kjo marrëveshje e forcoi Partinë Socialiste dhe i dha asaj pushtetin absolut në parlament, atëherë duhet të biem dakord se kjo marrëveshje dështoi dhe dikush duhet të mbajë përgjegjësi.

Kush e solli situatën e sotme? Kush e bëri Edi Ramën perandor? Pa dyshim që edhe kjo ishte një marrëveshje tjetër mes Bashës dhe Kryemadhit, sepse ata së bashku kërkuar që deputetët e tyre të dalin nga parlamenti; ata kërkuar ta bënin Edi Ramën perandor; ata kërkuar që Edi Rama të rikthente dhe të riinstalonte diktaturën në vend.

Përballë kësaj qeverie skandaloze dhe kësaj marrëveshjeje që instaloi këtë regjim, e cila sipas të gjitha mediave ka kapur çdo pushtet, opozita parlamentare duhet të qëndrojë në parlament, sepse është e vetmja rrugë e drejtë. Ne duhet të

qasim ndryshimet e duhura për vendin tonë dhe të mbështesim reformën në drejtësi, e cila po zvarritet pafund nga Partia Socialiste dhe po atakohet nga partitë jashtë parlamentit.

Ne duhet t'i dimë meritat tona, sepse nga kjo opozitë në parlament u mbyll paketa e reformës në drejtësi.

Është ky parlament dhe kjo opozitë që do të realizojnë reformën zgjedhore. Në këtë sesion ky parlament do të miratojë planin afatgjatë për ndryshimet e duhura në sistemin zgjedhor.

Më lejoni të bëj një bilanc për atë që ka ndodhur deri më tani. Pavarësisht marrëveshjes së fundit, që u bë për abandonimin e parlamentit, pavarësisht dobësimit të tij, Kuvendi i Shqipërisë arriti të jetë produktiv, sepse mbrojti reformën në drejtësi dhe këmbënguli në faktin se ne duhet ta ndryshojmë këtë sistem, i cili ka kapur të gjithë shoqërinë shqiptare. Paketa e reformës në drejtësi është një nga ligjet më të votuara në sesionin e shkuar.

Shqiptarët me padurim po presin ngritjen e Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të reja të drejtësisë, si SPAK-un dhe BKH-në.

Detyra jonë është që ta mbyllim reformën zgjedhore dhe me patjetër t'u japim shqiptarëve atë që gjithmonë kanë kërkuar: zgjedhje të lira dhe të ndershme. Sa më shumë kalon koha, aq më shumë bindemi se ky është misioni ynë.

Kjo opozitë e dha shembullin e parë për fjalën e lirë, e cila fiton mbi çdo tjetër, fiton mbi partitokracinë dhe mbi çdo kryetar partie që mundohet të udhëheqë partinë e tij.

Reforma zgjedhore do të jetë prioritet mbi prioritetet. Kjo reformë do t'i japë fund këtij sistemi që ka mbytur demokracinë e brendshme në parti. Ne nuk do të kemi kurrë një qeverisje të mirë nëse qeveria prodhon autokraci. Ndryshimi i sistemit do të jetë kryefjala e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore.

Në javët në vijim do të organizohet një tryezë gjithëpërfshirëse, ku do të marrin pjesë partitë politike në vend dhe shoqëria civile, për të ndarë shqetësimet dhe problemet në lidhje me sistemin zgjedhor.

Ne si opozitë jemi pro ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore për të arritur një sistem, i cili nuk do të jetë më i skllavëruar nga kryetarët e partive, një sistem që do të ofrojë kandidatë të denjë dhe konkurrentë të drejtë. Depolitizimi i

administratës zgjedhore duhet të jetë gjithashtu një mision i kësaj reforme.

Ne do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë edhe votës së diasporës. Ata meritojnë të kenë përfaqësimin e tyre në parlament.

Në përfundim, këto janë tri elementet kyçe që ka opozita në parlament dhe do të kemi një mbështetje të gjerë nga grupet parlamentare të opozitës. Ne do të vijojmë ta përshkojmë të gjithë Shqipërinë. Grupi Demokrat do të shkojë përpara dhe do të vizitojë çdo qytet e fshat për të treguar platformën e tij dhe për të ofruar alternativën e drejtë, demokrate, për Shqipërinë.

Unë kam bindjen e plotë që Edi Rama është i mbrojtur nga Basha dhe nga Monika Kryemadhi. Ata me dështimin e tyre të madh i larguan deputetët nga parlamenti i Shqipërisë për një qëllim të vetëm: ata nuk e duan zhvillimin e këtij vendi. Përballë kësaj qeverie skandaloze, përballë Edi Ramës, në këtë pikë ku jemi sot, unë dhe Grupi Parlamentar Demokrat, si dhe cilido tjetër që do të bëjë një betejë për ringritjen e të djathtës shqiptare, është i mirëpritur që të fillojmë udhëtimin tonë, të shkojmë qytet më qytet, fshat më fshat për t'i dhënë çdo qytetari një zë. Ne nuk do ta ndalojmë kurrë betejën për të vënë në vend demokracinë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zoti Taulant Balla.

Taulant Balla - Pa dyshim që Kryetari i Kuvendit bëri një përmbledhje ezauruese të sfidave që na presin së bashku në këta katër muaj të këtij sesiioni të ri parlamentar.

Së pari, detyra e ne të gjithëve është që të bashkohemi për objektivin madhor të Shqipërisë, i cili pritet të konkludohet në Këshillin European në tetor të këtij viti, dhe të gjithë kemi besimin e plotë se bashkë me Maqedoninë e Veriut e meritojmë plotësisht fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Fillimi i bisedimeve për anëtarësim nuk është një fitore vetëm e qeverisë apo e shumicës sonë, por, së pari, është një moment i rëndësishëm për të gjithë shqiptarët dhe për aspiratën tonë historike për integrim euroatlantik.

Pa dyshim, si kryetar i shumicës në këtë Kuvend, di ta vlerësoj shumë mirë edhe rolin tuaj, të nderuar deputetë të opozitës, në muajt e shkuar në përpjekjet e përbashkëta për të votuar

edhe ligjet e fundit të paketës së reformës në drejtësi. Dua t'ju falënderoj për konsensusin lidhur me ato që janë çështje madhore dhe dëshiroj që në frymën e bashkëpunimit, që kemi pasur gjatë gjashtë muajve të fundit, të vijojmë edhe për sfidat që na presin përpara.

Së dyti, reforma zgjedhore është kryefjala e këtij sesiioni të ri parlamentar që fillojmë sot jo vetëm me ju, por edhe me opozitën që ndodhet jashtë parlamentit, së cilës i kemi rezervuar në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore vendin e saj, duke i garantuar Partisë Demokratike, si partia më e madhe në opozitë, një karrige, për të cilën i kemi garantuar edhe veton. Ashtu si deputetët tanë, si përfaqësues të Partisë Socialiste apo edhe ju, edhe Partia Demokratike e ka vendin në këtë Komision.

Unë e ripërsëris edhe një herë publikisht atë që Kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama, rishprehu para pak javësh: ne mirëpresim që edhe Partia Demokratike, opozita jashtëparlamentare, të ushtrojë të drejtën e saj për t'u përfaqësuar në këtë Komision, por puna në Kuvend do të vazhdojë; së bashku do të vazhdojmë punën në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe sot kemi dakordësuar në Konferencën e Kryetarëve edhe zgjerimin e përfaqësimit të grupit më të ri parlamentar të opozitës. Këtë e kemi kaluar me konsensus dhe mezi pres që në seancën pasardhëse të votojmë edhe rritjen e përfaqësimit të partive të tjera politike të përfaqësuara në Kuvendin e Shqipërisë.

Së treti, dua të rishpreh domosdoshmërinë e vijimit të angazhimit të të gjitha forcave politike të përfaqësuara në Kuvend lidhur me çuarjen më tej të implementimit të plotë të reformës në drejtësi. Kujtoj këtu që Kuvendi ripërfshihet në rolin që luan, qoftë në përzgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë vende të caktuara që përzgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë, qoftë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë apo për Prokurorin e ri të Përgjithshëm. Jemi në afatet e fundit që këto institucione të marrin udhë dhe të fillojë menjëherë puna.

Së katërti, kemi një çështje, e cila ka marrë shumë vëmendje publike këto ditë dhe këto javë, që lidhet me mangësitë e vërejtura në kuadrin ligjor të garantimit të integritetit të personave që zgjidhen apo që emërohen. Rasti i Shkodrës na

bën të vetëdijshëm që kuadri ligjor ekzistues nuk është ende i plotë. Në këtë këndvështrim Kryeministri, zoti Edi Rama, më shumë në cilësinë e deputetit sesa atë të Kryeministrit, ka njoftuar se do të depozitojë në Komisionin e Reformës Zgjedhore, si amendamente shtrëngimet e domosdoshme dhe më të ashpra lidhur me pastërtinë e figurës së çdo kandidati. Le të jetë Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore ai që do t'i shqyrtojë të gjitha këto propozime së bashku me ju, ku pa dyshim mirëpresim çdo vërejtje dhe çdo propozim që mund ta pasurojnë këtë nismë të vyer, në funksion të rritjes së rritjes së parandalimit, që çdo person me të shkuar problematike të arrijë të zgjidhet qoftë në Kuvendin e Shqipërisë, qoftë në krye të bashkive, qoftë në këshillat bashkiakë apo të emërohet në pozicione, për të cilat ligji e përcakton qartë se këta persona nuk mund të emërohen.

Së pesti, ky është një sesion i ri parlamentar që fillon me një Rregullore të re të Kuvendit të Shqipërisë. Ndoshta një pjesë ende nuk janë njohur me një reformë të rëndësishme që kemi bërë në jetën parlamentare në fund të sesionit të kaluar.

Së fundi, për ata që na kanë sjellë në këtë sallë, për zgjedhësit tanë, nuk do të jenë vetëm e premtja, e shtuna apo e diela si kohë në dispozicion për t'u përkushtuar atyre, por, ashtu si në parlamentet me demokraci të konsoliduar, ashtu si në Parlamentin Europian, ne do të kemi një javë dedikuar tërësisht punës me zgjedhësit. Është një javë pune intensive, që kërkon rritjen e prezencës së deputetëve në zonat e tyre zgjedhore.

Dua t'u kujtoj deputetëve të opozitës që në çdo qendër qarku ka një zyrë të deputetëve të shumicës dhe një zyrë të deputetëve të opozitës, ku deputetët duhet të jenë të pranishëm në këto zyra për t'u takuar me njerëzit në fund të kësaj jave dhe në fillim të javës së re parlamentare do të kemi një seancë të posaçme dedikuar zgjedhësve. Deputetët, në prani të kabinetit të qeverisë, duhet të sjellin në sallë të gjitha problematikat e hasura gjatë kontakteve me njerëzit. Po ashtu, është koha të rikthehemi te domosdoshmëria e rritjes së kontrollit parlamentar, qoftë nga shumica parlamentare, qoftë nga opozita. Ndryshimet e reja në Rregullore u kanë dhënë më shumë hapësirë

deputetëve të opozitës për ta ushtruar këtë kontroll.

Gjithashtu, dua t'u kujtoj të gjithë deputetëve në këtë seancë të parë të këtij sesioni të ri parlamentar se ne kemi detyrën të përfaqësojmë shqiptarët pa dallim krahësh politikë, sepse, në fund të fundit, këtu na kanë sjellë partitë, por ne jemi këtu për të përfaqësuar popullin shqiptar. Në këtë këndvështrim, dua ta mbyll fjalën time me atë që thashë në fillim: për reforma të rëndësishme ne duhet të jemi bashkë.

Zonja Hajdari si kryefjalë të objektivit të saj, si kryetare e Grupit Parlamentar Demokrat, përmendi ndryshimin e sistemit zgjedhor. Zonja Hajdari, objektivi kryesor i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore është adresimi i plotë i rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it të nxjerra në raportet e viteve 2013, 2015 dhe 2017, ku, pa dyshim, komisioni do të ketë kohën e nevojshme për të shqyrtuar rekomandimet e raportit të fundit, atë të zgjedhjeve të 30 qershorit. Duhet ta pranojmë të gjithë se zgjedhjet e 30 qershorit ishin një festë e demokracisë, fitoi e drejta kushtetuese e çdo shqiptari për të votuar dhe, pa dyshim, humbën ata që u bënë bashkë për t'ua mohuar këtë të drejtë shqiptarëve. Është domosdoshmëri që të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, pa asnjë dallim, të formësohen në ndryshime në Kodin Zgjedhor. Ne duhet domosdoshmërisht që në zgjedhjet e qershorit të vitit 2021 t'u garantojmë të gjithë shqiptarëve, kudo që ata jetojnë, sikurse edhe ju keni jetuar shumë vite jashtë Shqipërisë, të votojnë për përfaqësuesit e tyre, madje shqiptarët që jetojnë jashtë territorit, në formën aktuale të sistemit zgjedhor, të kenë pa dyshim edhe përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

E dyta, e kemi thënë dhe e kemi stërthënë, ka ikur koha që partitë politike të votohen dhe po ato parti të numërojnë votat që japin shqiptarët. Pa dyshim, në këtë këndvështrim duhet të ndryshojmë tërësisht dhe të depolitizojmë të gjithë infrastrukturën e administrimit të procesit zgjedhor. Për këtë, bujrum, hajdeni të punojmë! Ne e kemi dhënë garancinë tonë për të hulumtuar dhe për t'i diskutuar së bashku mundësitë e sistemeve zgjedhore, por detyrimet e Shqipërisë janë dhe lidhen tërësisht me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Faleminderit!

Punë të mbarë Kuvendit të Shqipërisë!

Gramoz Ruçi- Faleminderit, zoti Balla!

(Pasi lexon rendin e ditës)

A ka ndonjë vërejtje për procesverbalin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari- Zoti Balla, meqenëse m'u drejtuar lidhur me reformën zgjedhore, ju e dini shumë mirë se kjo reformë ka nevojë për një konsensus të gjerë dhe si bashkëkryetare e këtij komisioni mendoj se në radhë të parë duhet të ndryshojmë bashkëkryetarin e këtij komisioni, në mënyrë që të bëhet një lëvizje e duhur dhe ky komision të ketë kredibilitetin e duhur për të bërë një reformë sa më të mirë zgjedhore.

Së dyti, nëse do të flasim për shkaqet e sistemit, duhet të shikoni se çfarë ka ndodhur sot në Shqipëri për faktin që ju flisni sot për zgjedhjet e 30 qershorit si një sukses i madh, unë nuk e di se çfarë të them. Ju flisni për zgjedhjet si një sukses i madh, ndërkohë që keni zgjedhur kandidat si Pjetri në Shkodër. Më thoni pse merreni me pasojat dhe jo me shkaqet? Pse merreni me këta individë dhe mendoni se fajin e ka ligji e duhet ta ndryshojmë atë, kur ndërkohë këtë njeri e sollët ju dhe e zgjodhi pikërisht kjo parti?! Jeni ju që i sillni këta njerëz në parlament. Prandaj, nëse kryetari i Partisë Socialiste, kryetari i Partisë Demokratike dhe kryetari i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim do të vazhdojnë të kenë dorë mbi partitë e tyre, ju do të vazhdoni të sillni njerëz të paaftë, kriminelë dhe do të bëni çdo gjë për të mbajtur pushtetin.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hajdari!

A ka ndonjë sugjerim për procesverbalin e seancës së fundit të sesionit të kaluar? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave janë depozituar 7 projektligje dhe 1 vendim i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për propozim të kandidaturës për Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga Presidenti i Republikës janë depozituar 5 dekrete për rishqyrtim ligji. Nga institucionet kushtetuese, konkretisht nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit është depozituar kërkesa për riklasifikim në kategorinë e pagave dhe shtesë në numrin e punonjësve. Listën me titujt e keni në tavolinat tuaja të punës. Materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit.

Njoftoj njëkohësisht për miratimin me konsensus të programit të punës dhe kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim.

Gjithashtu, ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi për draftprogramin e punës dhe draftkalendarin 3-javor për periudhën në vijim. Në Konferencë pati konsensus dhe për pasojë, në mbështetje të nenit 26, pika 5, dhe nenit 27, pika 3, të Rregullores, programi dhe kalendar i njoftohen Kuvendit. Materialet do t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit.

Faleminderit!

Seancën e deklaroj të mbyllur.

Të vazhdojë puna në komisione për përgatitjen e seancës plenare të radhës!

(Seanca u mbyll në orën 19:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

Parlamentare

Krenar Hajdëri